

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

MAKINA METALPUNUESE

(Niveli III i KSHK)

(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor “Mekanikë”)

Kodi: F1-III-20

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i Kornizësh Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Mekanikë”.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK

III. Plani mësimor për profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK.

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Mekanik”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli II, të drejtimit “Mekanik”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e makinave metalpunuese.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Makina metalpunuese” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Mekanik”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale të punimeve me makina metalpunuese.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të punimeve me makina metalpunuese.
- Të zbatojë standardet e profesionit.
- Të interpretojë dhe të përgatitë dokumentacionin teknik për punime në makinat metalpunuese.
- Të projektojë procesin teknologjik të prodhimit të detaleve me vështirësi mesatare me makina metalpunuese.
- Të përgatitë vizatimet dhe skicat e punës së detaleve që prodhohen me makina metalpunuese.
- Të përzgjedhë materialet (copat) për prodhimin e detaleve në makinat metalpunuese.
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse për prodhimin e detaleve në makinat metalpunuese.
- Të përzgjedhë instrumentet prerëse për prodhimin e detaleve në makinat metalpunuese.
- Të bëjë kontrollin e saktësisë së makinave metalprerëse (tornos, frezës, etj.)
- Të kryejë matje, kontrolle dhe shënime për punimet në makinat metalpunuese.
- Të përgatitë për punë dhe të rregullojë regjimet e punës në makinat metalpunuese.
- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave tornuese të cilësisë IT7 – IT11.
- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave frezuese të cilësisë IT7 – IT11.
- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave zdruguese të cilësisë IT7 – IT11.
- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave shpuese kollonë të cilësisë IT7 – IT11.
- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave retifikuese të cilësisë IT7 – IT11.
- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave kthyesë.

- Të prodhojë detale metalike me përdorimin e makinave prerëse.
- Të tregojë kujdesin e duhur dhe të mirëmbajë vendin e punës, veglat, pajisjet, instrumentet dhe makinat metalpunuese.
- Të komunikojë me etikën e duhur në kuadrin e veprimtarisë profesionale.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje, reparte dhe servise të ndryshme që kryejnë punime dhe prodhime makina metalpunuese. Gjithashtu, me përvojë pune të mëtejshme, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose të krijojë biznesin e tij në fushën e punimeve me makina metalpunuese. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin “Mekanikë”, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-04-254-19	Makina metalpunuese	3
3	L-04-255-19	Rezistencë materialesh	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-04-768-19	Punime në makinat tornuese - 2	51
2	M-04-769-19	Punime në makinat frezuese - 2	51
3	M-04-770-19	Punime në makinat zdruguese - 2	51

4	M-04-771-19	Punime në makinat e shpuese kollonë	51
5	M-04-772-19	Punime në makinat retifikuese	51
6	M-04-773-19	Punime në makinat prerëse	36
7	M-04-774-19	Punime në makinat kthyese	33
8	M-04-1582-19	Projekti i prodhimit të detalit me makina metalpunuese	84
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-04-776-19	Punime në makinat barenuese	51
2	M-04-777-19	Punime në makinat shpuese rrezore	51
3	M-04-778-19	Punime në makinat kalandruese	51
4	M-04-1583-19	Punimi i kremalierave të sakta në makinat frezuese	51
5	M-04-1584-19	Punimi i kanaleve elikoidale në makinat frezuese	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Makina metalpunuese”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli II i KSHKI, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehjeve, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e makinave metalpunuese, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Makina metalpunuese”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë**

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë

Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Makina metalpunuese”, (L-04-254-19). Kl. 12 – 102 orë

- **Synimet e lëndës “Makina metalpunuese”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Makina metalpunuese”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë veçoritë e procesit të prodhimit dhe atij teknologjik, në makinat metalprerëse (frezuese, barenuese, zdruguese, retifikuese etj.).
- Të përshkruajnë qëllimin dhe ndërtimin e makinave metalprerëse (frezuese, barenuese, zdruguese, retifikuese etj.).
- Të përcaktojnë grupin të cilit i përkasin makinat e ndryshme metalprerëse.
- Të përshkruajnë gjeometrinë e instrumentave të makinave metalprerëse (frezuese, barenuese, zdruguese, retifikuese etj.) dhe të tregojnë ndikimin e tyre në procesin e prerjes.
- Të përshkruajnë regjimet e prerjes në makinat frezuese, barenuese, zdruguese, retifikuese etj., si dhe ndikimin e tyre në procesin e prerjes.
- Të përshkruajnë procesin e punimit të detaleve tipike në makinat zdruguese.
- Të përshkruajnë procesin e punimit të detaleve tipike në makinat barenuese.
- Të përshkruajnë procesin e punimit të detaleve tipike në makinat frezuese.
- Të përshkruajnë procesin e punimit të detaleve tipike në makinat retifikuese.
- Të përshkruajnë veçoritë e procesit të punimit të terheqës.
- Të përshkruajnë veçoritë e makinave metalprerëse me drejtim të programuar numerik CNC, epërsitë e tyre në procesin e punimit mekanik të detaleve.
- Të përcaktojnë procedurën e punimit të një detali të thjeshtë duke përcaktuar instrumentat prerëse që duhet të përdoren.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Makina metalpunuese”, kl. 12 – 102 orë**

Tema 1	Procesi i zdrugimit, veçoritë e tij.	1 orë
Tema 2	Elementet e regjimit të prerjes në zdrugim.	3 orë
Tema 3	Instrumentat prerëse të zdrugimit, gjeometria e tyre.	3 orë
Tema 4	Tipet e thikave zdruguese.	2 orë
Tema 5	Makinat zdruguese, llojet, ndërtimi dhe kinematika e tyre.	3 orë
Tema 6	Lloje punimi në makinat zdruguese.	5 orë

Tema 7	Procesi i barenimit, veçorite e tij.	1 orë
Tema 8	Makinat barenuese, ndertimi i tyre.	2 orë
Tema 9	Instrumentat e barenimit, llojet e tyre.	2 orë
Tema 10	Vendosja dhe shterngimi i detaleve ne barenu.	2 orë
Tema 11	Lloje punimi ne makinat barenuese.	3 orë
Tema 12	Procesi i punimit ne makinat terheqese, veçorite e tij.	3 orë
Tema 13	Elementet e regjimeve te prerjes në makinat tërheqëse.	3 orë
Tema 14	Makinat terheqese, llojet e tyre.	2 orë
Tema 15	Procesi i frezimit, veçorite e tij.	2 orë
Tema 16	Makinat frezuese, llojet, ndertimi dhe kinematika e tyre.	4 orë
Tema 17	Instrumentat frezues, klasifikimi dhe gjeometria e tyre.	4 orë
Tema 18	Regjimet e prerjes ne procesin e frezimit.	3 orë
Tema 19	Kokat ndarese, ndertimi i tyre, ndarja e thjeshte dhe diferenciale.	4 orë
Tema 20	Zbatime mbi ndarjen e thjeshte dhe diferenciale.	6 orë
Tema 21	Punime tipike që realizohen ne makinat frezuese (kanalet elikoidale, rrotat me dhëmbë të drejtë dhe të pjerrët, kremalierat etj.).	10 orë
Tema 22	Përgatitja e makines frezuese për pune.	4 orë
Tema 23	Procesi retifikimit, veçorite e tij.	2 orë
Tema 24	Makinat retifikuese, llojet, ndertimi dhe skema kinematike e tyre.	5 orë
Tema 25	Instrumentat prerese abrazive, ndërtimi, llojet, klasifikimi dhe zgjedhja.	4 orë
Tema 26	Regjimet e prerjes ne retifikim.	3 orë
Tema 27	Punime tipike ne makinat retifikuese.	4 orë
Tema 28	Punime ne makinat speciale (makinat dhembe prerese etj.).	4 orë
Tema 29	Makinat kthyes (piegatriçet, kalandrat, bordatriçet etj.). Punimet që realizohen.	3 orë
Tema 30	Makinat prerëse (sharrat mekanike, diskore, tranxhat, gërshërët elektrike etj.). Punimet që realizohen.	3 orë
Tema 31	Njohuri për makinat me drejtim të programuar numerik CNC	2 orë

3. Lënda “Rezistencë materialesh”, (L-04-255-19). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Rezistencë materialesh”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Rezistencë materialesh”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë qëllimin dhe rëndësinë e lëndës së rezistences se materialeve.
- Të shpjegojnë ç'kuptojme me shprehjen “material i qendrueshem”
- Të shpjegojnë pse nje problem i rezistences se materialeve me pare eshte problem i statikes.
- Te shpjegojne pse disa parime te statikes nuk mund te zbatohen ne rezistencen e materialeve.
- Të shpjegojnë ç'eshte trau ne rezistencen e materialeve.
- Të shpjegojnë ç'eshte tensioni ne rezistencen e materialeve.
- Të shpjegojnë ç'fare provash i behen materialeve dhe pse?
- Të shpjegojnë ç'eshte tensioni i lejuar, ç'është koeficienti i sigurise dhe si zgjidhen ato.
- Të shpjegojnë ç'eshte terheqja dhe shtypja dhe cili eshte dallimi ndermjet tyre.
- Të shpjegojnë ç'kuptojme me qendrueshmeri ne terheqje dhe shtypje.

- Të interpretojnë marrëdhëniet ndërmjet zgjatimit, ngarkesës, seksionit dhe modulit të elasticitetit.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të qendrueshmerise në tërheqje dhe në shtypje.
- Të shpjegojnë ç'është prerja dhe qendrueshmeria në prerje.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të detaleve që punojnë në prerje.
- Të shpjegojnë ç'janë karakteristikat gjeometrike të sipërfaqeve të thjeshta.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta për karakteristikat gjeometrike të sipërfaqeve.
- Të shpjegojnë ç'është përdredhja dhe qendrueshmeria në përdredhje.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të detaleve që punojnë në përdredhje.
- Të shpjegojnë ç'është përkulja e rrafshet e thjeshte, hipotezat mbi të cilat mbështetet studimi i përkuljes së rrafshet të thjeshte.
- Të shpjegojnë ç'kuptojmë me qendrueshmeri në përkulje.
- Të ndertojnë diagramen e forcës prerëse dhe të momentit përkulës.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të trupave që punojnë në përkulje.
- Të shpjegojnë ç'është rezistenca e përbere, të tregojnë shembuj nga praktika.
- Të shpjegojnë ndryshimin ndërmjet rezistencës së përbere dhe rezistencës së thjeshte.
- Të bëjnë llogaritje të thjeshta të trupave që punojnë në rezistencë të përbere.
- Të shpjegojnë ç'është epja duke dhënë shembuj detalesh që punojnë në epje.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Rezistencë materiale”, kl. 12 – 68 orë**

Tema 1	Hyrje në rezistencën e materialeve.	2 orë
Tema 2	Traut në rezistencën e materialeve, tensionet, provat e materialeve, tensioni i lejuar, koeficienti i sigurisë.	3 orë
Tema 3	Tërheqja, kushti i qëndrueshmerisë në tërheqje.	2 orë
Tema 4	Marrëdhëniet ndërmjet zgjatimit, ngarkesës, seksionit dhe modulit të elasticitetit. Ushtrime për tërheqjen	5 orë
Tema 5	Shtypja, kushti qëndrueshmërisë në shtypje.	2 orë
Tema 6	Prerja, kushti qëndrueshmërisë në prerje.	4 orë
Tema 7	Karakteristikat gjeometrike të sipërfaqeve të rrafshuta. Ushtrime	8 orë
Tema 8	Përdredhja, tensioni tangencial në përdredhje, shprehja e parë e tensionit tangencial.	3 orë
Tema 9	Këndi relativ i përdredhjes dhe tensioni.	3 orë
Tema 10	Shembuj të llogaritjes në përdredhje.	4 orë
Tema 11	Përkulja. Momenti përkulës dhe forcës prerëse.	3 orë
Tema 12	Diagrama e forcës prerëse dhe e momentit përkulës.	6 orë
Tema 13	Shformimet në përkulje, kushti i qëndrueshmërisë në përkulje.	6 orë
Tema 14	Shembuj zbatimi dhe ushtrime për përkuljen.	5 orë
Tema 15	Rezistenca e përbërë. Përkulja dhe përdredhja.	4 orë
Tema 16	Përkulja dhe tërheqja ose shtypja. Ushtrime	6 orë
Tema 17	Epja, ngarkesa kritike dhe tensionet kritike.	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Punime në makinat tornuese - 2”

Drejtimi: Mekanikë
Profili: Makina metalpunuese
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME NE MAKINAT TORNUESE - 2	M-04-768-19
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese tornimi dhe për prodhuar detale metalike të një vështirësie mesatare (me saktësi IT7 – IT11 dhe me ashpërsi Ra 3,2 – Ra 6,3) me përdorimin e makinave tornuese.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Mekanikë”, niveli II i KSHK	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen procese tornimi të një vështirësie mesatare Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë skicat ose vizatimet e detaleve që do të punohen, p.sh. tornimi i boshteve të gjatë me anë të lunetës së palëvizshme dhe të lëvizshme, punimi i sipërfaqeve të jashtme konike me ndihmën e kundramajës dhe vizores konike etj.– të ndezë dhe të përgatitë tornon për punë.– të përzgjedhë drejt instrumentat metalprerëse për tornimet që do të kryhen.– të përzgjedhë drejt instrumentat matëse.– të vendosë saktë instrumentat metalprerës sipas rradhës së punimit.– të përzgjedhë materialet (copat) e duhura që do të punohen me tornim.– të përzgjedh drejt paisjet ndihmëse për punimin e detaleve në torno.– të vendosë dhe të shtrëngojë në mandrino copat që do të punohen me tornim.– të vendosë instrumentat prerëse në mbajtësen e thikave të	

tornos.

- të përzgjedhë dhe të rregullojë si duhet regjimet e tornimit.
- të tornojë (me disa kalime) sipërfaqet e jashtme cilindrike (boshtet) të gjata $l/d > 10-12$, pa shkallëzime, të detalit.
- të tornojë (me disa kalime) sipërfaqet e jashtme cilindrike, me shkallëzime, të detalit.
- të tornojë (me disa kalime) sipërfaqet e brendshme cilindrike, pa shkallëzime, të detalit.
- të tornojë (me disa kalime) sipërfaqet e brendshme cilindrike, me shkallëzime, të detalit.
- të tornojë (me disa kalime) sipërfaqet e jashtme konike të detalit me anë të zhvendosjes së kundramajës.
- të tornojë sipërfaqen e jashtme konike të detalit me anë të vizores konike.
- të tornojë sipërfaqet e jashtme, të profiluara të detalit.
- të tornojë me thikë filetot e jashtme të detalit, me dy fillesa, me profil trekëndor, me përdorimin e kutisë së ushqimit dhe kitarës.
- të tornojë me thikë filetot e jashtme të detalit, me një fillesë, me profil drejtkëndor, me përdorimin e kutisë së ushqimit dhe kitarës.
- të tornojë me thikë filetot e jashtme të detalit, me dy fillesa, me profil drejtkëndor, me përdorimin e kutisë së ushqimit dhe kitarës.
- të tornojë me thikë filetot e brendshme të detalit, me një fillesë, me profil trekëndor, me përdorimin e kutisë së ushqimit dhe kitarës.
- të kryejë matje dhe kontrole me instrumentat përkatëse.
- të kujdeset për tornon, instrumentet, veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë tornimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi punon detale që nuk kanë aks simetrie (tip korpusi) me anë të tornimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë skicën (ose vizatimin) e punës së detalit që do të prodhohet me tornim.
- të përcaktojë procesin teknologjik të prodhimit të detalit me tornim.
- të përzgjedhë copën për prodhimin e detalit me tornim.
- të përzgjedhë instrumentet metalprerëse dhe pajisjet ndihmëse që do të përdoren për prodhimin e detalit me tornim.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme.

- të përzgjedhë pajisjet vendosëse (mandrino me katër nofulla të pamvarura ose pllato).
- të përzgjedhë instrumentet matëse dhe kontrolluese.
- të përgatitë vendin e punës.
- të ndezë dhe të përgatitë tornon për punë.
- të vendosë dhe të shtrëngojë në pajisjen vendosëse (mandrino me katër nofulla të pavarura) ose në pllato copën që do të punohet, si dhe të lirojë e të heqë atë nga pajisja vendosëse, sipas proceseve që do të kryhen.
- të vendosë instrumentet prerëse në mbajtësen e thikave të tornos dhe të heqë ato sipas proceseve që do të kryhen.
- të përzgjedhë dhe të rregullojë regjimet e tornimit, sipas proceseve që do të kryhen.
- të kryejë tornime të ndryshme për prodhimin e detalit, sipas kërkesave të skicës (vizatimit) dhe sipas procesit teknologjik të përcaktuar.
- të kryejë matje dhe kontrole të ndërmjetme dhe përfundimtare të detalit, me instrumentat përkatëse.
- të heqë nga pajisja vendosëse detalin e punuar me anë të tornimit.
- të kujdeset për tornon, instrumentet, veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë tornimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi plotëson dokumentacionin teknik dhe financiar për prodhimin e detalit me anë të tornimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë preventivin e materialeve të përdorura për prodhimin e detalit me tornim.
- të llogarisë koston për materialet e përdorura për prodhimin e detalit me tornim.
- të llogarisë kohën e punës dhe koston e punës për prodhimin e detalit me tornim.
- të llogarisë kosto të tjera (energji, materiale konsumi, pajisje, instrumenta etj.) për prodhimin e detalit me tornim.
- të llogarisë koston e plotë të detalit të prodhuar me tornim.
- të llogarisë çmimin e detalit të prodhuar me tornim.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të detalit të prodhuar me tornim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e makinave metalprerëse të shkollës ose në reparte të bizneseve ku kryhen punime me makina tornuese.

-
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të tornimit për prodhimin e detaleve të ndryshme, si dhe të mënyrës së plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Mësuesi i praktikës duhet tu japë nxënësve detyra konkrete për prodhimin e detaleve komplekse me anë të tornimit.
 - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për skicimin, vizatimin dhe prodhimin e detaleve me anë të tornimit, si dhe për llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e financiar të tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet e tornimit që kryejnë.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për prodhimin e detaleve komplekse me tornim.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së tornimit.
 - Makinë tornuese universale.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune tornimi.
 - Instrumente metalprerëse për tornim.
 - Copa të ndryshme metalike për punime tornimi.
 - Modele të detaleve metalike të prodhuara me tornim.
 - Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme që punohen me tornim.
 - Formate të dokumentacionit tekniko-financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Punime në makinat frezuese - 2”

Drejtimi: Mekanikë
Profili: Makina metalpunuese
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NE MAKINAT FREZUESE - 2	M-04-769-19
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese frezimi dhe për prodhuar detale metalike të një vështirësie mesatare (me saktësi IT7 – IT11) me përdorimin e makinave frezuese.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Mekanikë”, niveli II i KSHK	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen procese frezimi të thjeshta. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë skicat ose vizatimet për proceset e frezimit që do të kryhen (p.sh., punimi i shumëfaqshave si prizëm drejtëkëndësh, gjashtëkëndësh etj.).– të ndezë dhe të përgatitë frezën për punë.– të përzgjedhë instrumentat metalprerëse dhe pajisjet ndihmëse për proceset e frezimit që do të kryhen.– të përzgjedhë instrumentat matëse të nevojshme.– të vendosë instrumentave metalprerëse sipas rradhës së punimit.– të përzgjedhë materialet e (copave) që do të punohen me procese të ndryshme frezimi.– të vendosë dhe të shtrëngojë si dhe të lirojë e të heqë kokën ndarëse në bangon e makinës frezuese (sipas kërkesave të procesit që do të kryhet).– të përgatitë kokën ndarëse për punë, sipas proceseve dhe regjimeve të punës.– të vendosë dhe të shtrëngojë si dhe të lirojë e të heqë copat që do të punohen, në bangon e makinës frezuese ose në kokën ndarëse, sipas proceseve që do të kryhen.– të vendosë dhe të shtrëngojë, si dhe të lirojë e të heqë instrumentet frezuese në mbajtësen përkatëse, sipas proceseve që do të kryhen.	

- të përzgjedhë dhe të rregullojë regjimet e frezimit sipas proceseve që do të kryhen.
- të frezojë (me disa kalime) faqet vertikale dhe horizontale të një detali shumëfaqësh, me përdorimin e kokës ndarëse.
- të kryejë matje dhe kontrole me instrumentat përkatëse.
- të kujdeset për frezën, instrumentet, veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë frezimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi prodhon detale të një vështirësie mesatare (rrotë cilindrike me dhëmbë të drejtë) me anë të frezimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë skicën (ose e vizatimit) e punës së rrotës cilindrike me dhëmbë të drejtë që do të prodhohet me frezim.
- të përcaktojë procesin teknologjik të prodhimit të rrotës cilindrike me dhëmbë të drejtë me frezim.
- të përzgjedhë copën për prodhimin e rrotës cilindrike me dhëmbë të drejtë, me frezim.
- të përzgjedhë instrumentet metalprerëse (kompletin e frezave) dhe pajisjet ndihmëse që do të përdoren për prodhimin e rrotës cilindrike me dhëmbë të drejtë, me frezim.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme.
- të përzgjedhë instrumentet matëse dhe kontrolluese.
- të përgatitë vendin e punës.
- të ndezë dhe të përgatitë frezën për punë.
- të vendosë dhe të shtrëngojë kokën ndarëse në bangon e makinës frezuese (sipas kërkesave të procesit që do të kryhet).
- të përgatitë kokën ndarëse për punë, sipas proceseve dhe regjimeve të punës.
- të vendosë dhe të shtrëngojë copat që do të punohen, në kokën ndarëse, sipas proceseve që do të kryhen.
- të vendosë dhe të shtrëngojë instrumentet frezuese në mbajtësen përkatëse, sipas proceseve që do të kryhen.
- të përzgjedhë dhe të rregullojë regjimet e frezimit sipas proceseve që do të kryhen.
- të kryejë frezime për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me dhëmbë të drejtë, sipas kërkesave të skicës (vizatimit) dhe sipas procesit teknologjik të përcaktuar.
- të kryejë matje dhe kontrole të ndërmjetme dhe përfundimtare të rrotës së dhëmbëzuar, me instrumentat përkatëse.
- të lirojë dhe të heqë rrotën e dhëmbëzuar të punuar me

- frezim, nga koka ndarëse.
- të lirojë dhe të heqë kokën ndarëse dhe instrumentet frezuese nga mbajtëset e tyre.
- të kujdeset për frezën, instrumentet, veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë frezimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi plotëson dokumentacionin teknik dhe financiar për prodhimin e detalit me anë të frezimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë preventivin e materialeve të përdorura për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me frezim.
- të llogarisë koston për materialet e përdorura për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me frezim.
- të llogarisë kohën e punës dhe koston e punës për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me frezim.
- të llogarisë kosto të tjera (energji, materiale konsumi, pajisje, instrumenta etj.) për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me frezim.
- të llogarisë koston e plotë të rrotave të dhëmbëzuara të prodhuar me frezim.
- të llogarisë çmimin e rrotave të dhëmbëzuara të prodhuar me frezim.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të rrotave të dhëmbëzuara të prodhuar me frezim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e makinave metalprerëse të shkollës ose në reparte të bizneseve ku kryhen punime me makina frezuese.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të frezimit për prodhimin e rrotave cilindrike me dhëmbë të drejtë, si dhe të mënyrës së plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar.
- Mësuesi i praktikës duhet tu japë nxënësve detyra konkrete për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me anë të frezimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për skicimin, vizatimin dhe prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me anë të frezimit, si dhe për llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e financiar të tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet e frezimit që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara me frezim.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së frezimit.
 - Makinë frezuese.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune frezimi.
 - Instrumente metalprerëse (kompleti i frezave) për frezim.
 - Copa të ndryshme metalike për punimin e rrotave cilindrike me dhëmbë të drejtë me anë të frezimit.
 - Modele të rrotave të dhëmbëzuara metalike të prodhuara me frezim.
 - Skica dhe vizatime teknike të rrotave të dhëmbëzuara të ndryshme që punohen me frezim.
 - Formate të dokumentacionit tekniko-financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

Drejtimi: Mekanikë
Profili: Makina metalpunuese
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NE MAKINAT ZDRUGUESE - 2	M-04-770-19
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese zdrugimi dhe për prodhuar detale metalike të një shkalle vështirësie mesatare (me saktësi IT7 – IT11, ose IT12 – IT18) me përdorimin e makinave zdruguese (limatriçeve ose stokatriçeve).	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Mekanikë”, niveli II i KSHK	
Rezultatet e të mësuarit (RM) procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen kryen punime të thjeshta dhe të një vështirësie mesatare në makinën zdruguese horizontale (limatriçe). Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë skicat ose vizatimet e detaleve që do të punohen.– të ndezë dhe të përgatitë makinën zdruguese (limatriçen) për punë.– të përzgjedhë drejt instrumentat metalprerëse për zdrugimet që do të kryhen.– të përzgjedhë drejt instrumentat matëse.– të vendosë saktë instrumentat metalprerës sipas rradhës së punimit.– të përzgjedhë materialet (copat) e duhura që do të punohen me zdrugim.– të vendosë dhe të shtrëngojë në bangon e makinës copat që do të punohen me zdrugim.– të vendosë instrumentat prerëse në mbajtësen e thikave të limatriçes.– të përzgjedhë dhe të rregullojë si duhet regjimet e zdrugimit.– të kryejë procedurat e zdrugimit (me disa kalime) të sipërfaqeve horizontale të detaleve.– të kryejë procedurat e zdrugimit (me disa kalime) të faqeve ballore të detaleve cilindrike.– të kryejë procedurat e hapjes së kanaleve në faqen ballore të trupave cilindrikë, me anë të punimit (me disa kalime)	

-
- në makinën zdruguese.
 - të kryejë procedurat e prerjes së copave metalike me anë të punimit në makinën zdruguese.
 - të kryejë procedurat e zdrugimeve të sipërfaqeve të profiluara.
 - të kryejë matje dhe kontrole me instrumentat përkatëse.
 - të kujdeset për makinën zdruguese, instrumentet, veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimit me makinën zdruguese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi kryen punime të thjeshta dhe të një vështirësie mesatare në makinën zdruguese vertikale (stokatriçe) prodhon detale komplekse me anë të zdrugimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatitë skicën (ose e vizatimin) e punës së detalit që do të prodhohet me zdrugim.
- të përcaktojë procesin teknologjik të prodhimit të detalit me zdrugim.
- të përzgjedhë copën për prodhimin e detalit me zdrugim.
- të përzgjedhë instrumentet metalprerëse dhe pajisjet ndihmëse që do të përdoren për prodhimin e detalit me zdrugim.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e nevojshme.
- të përzgjedhë instrumentet matëse dhe kontrolluese.
- të përgatitë vendin e punës.
- të ndezë dhe të përgatitë makinën zdruguese për punë.
- të vendosë dhe të shtrëngojë në bangon e makinës zdruguese copën që do të punohet.
- të vendosë dhe të shtrëngojë instrumentet zdruguese në mbajtësen, sipas proceseve që do të kryhen.
- të përzgjedhë dhe të rregullojë regjime të zdrugimit, sipas proceseve që do të kryhen.
- të kryejë zdrugimet sipas kërkesave të skicës (vizatimit) dhe sipas procesit teknologjik të përcaktuar:
- të kryejë zdrugimin e sipërfaqeve anësore (vertikale) të detalit tip pllakë.
- të kryejë zdrugimin e folesë me seksion drejtëkëndësh të matricës së një stampe prerjeje (detal tip pllakë).
- të bëjë hapjen e kanaleve të kiavetës në mocon e një pulexhe.
- të kryejë punimin e dhëmbëve të një rrote yll.
- të kryejë matje dhe kontrole të ndërmjetme dhe përfundimtare të detalit, me instrumentat përkatëse.
- të lirojë dhe të heqë nga bangoja detalin e prodhuar me procese të ndryshme zdrugimi.

- të lirojë dhe të heqë instrumentet zdruguese nga mbajtësja e tyre.
- të kujdeset për makinën zdruguese, instrumentet, veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zdrugimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Nxënësi plotëson dokumentacionin teknik dhe financiar për prodhimin e detalit me anë të zdrugimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë preventivin e materialeve të përdorura për prodhimin e detalit me zdrugim.
- të llogaritë koston për materialet e përdorura për prodhimin e detalit me zdrugim.
- të llogaritë kohën e punës dhe koston së punës për prodhimin e detalit me zdrugim.
- të llogaritë kosto të tjera (energji, materiale konsumi, pajisje, instrumenta etj.) për prodhimin e detalit me zdrugim.
- të llogaritë koston e plotë të detalit të prodhuar me zdrugim.
- të llogaritë çmimin e detalit të prodhuar me zdrugim.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të detalit të prodhuar me zdrugim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e makinave metalprerëse të shkollës ose në reparte të bizneseve ku kryhen punime me makina zdruguese.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të zrugimit për prodhimin e detaleve të ndryshme, si dhe të mënyrës së plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar.
- Mësuesi i praktikës duhet tu japë nxënësve detyra konkrete për prodhimin e detaleve komplekse me anë të zdrugimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për skicimin, vizatimin dhe prodhimin e detaleve me anë të zdrugimit, si dhe për llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e financiar të tyre, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me punimet e zdrugimit që kryejnë
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për prodhimin e detaleve komplekse me zdrugim.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për

çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së zdrugimit.
- Makinë zdruguese.
- Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune zdrugimi.
- Instrumente metalprerëse për zdrugim.
- Copa të ndryshme metalike për punime zdrugimi.
- Modele të detaleve metalike të prodhuara me zdrugim.
- Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme që punohen me zdrugim.
- Formate të dokumentacionit tekniko-financiar.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Punime në makinat shpuese kollonë”

Drejtimi: Mekanikë
Profili: Makina metalpunuese
Niveli: III i KSHK
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NE MAKINAT SHPUSE KOLLONE	M-04-771-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer punime të shpimit të copave metalike në makinat e shpimit (trapano kollonë) me saktësi IT8-IT9).	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Mekanikë”, niveli II i KSHK	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punime të shpimit me Ø15÷Ø60 mm të sipërfaqeve të rrafshta, në copa metalike. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> – të analizojë skicën ose vizatimin e detalit që do të punohet me anë të shpimit me trapano kollonë. – të ndezë dhe të përgatitë për punë trapanon kollonë. – të përzgjedhë veglat dhe instrumentat metalprerëse (majat shpuese) të duhura për shpimin e detaleve. – të përzgjedhë pajisjet ndihmëse të duhura. – të përzgjedhë instrumentat matëse dhe kontrolluese të duhura. – të përzgjedhë materialin (copën) që do të punohet. – të vendosë copën që do të punohet në bangen e trapanos kollonë. – të vendosë dhe shtrëngojë në mandrino majën shpuese (ponton). – të rregullojë saktë regjimet e duhura të prerjes. – të kryejë shpimin (me disa kalime) të vrimave në sipërfaqe të rrafshta të copave metalike. – të bëjë ndërrimin e majave shpuese. – të bëjë ndërrimin e regjimeve të shpimit. – të kryejë rishpimin (nëse është e nevojshme). – të kryejë matje dhe kontrole të sakta me instrumentat përkatëse. – të heqë copën e shpuar nga banga e trapanos kollonë. – të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës. – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë shpimit të copave me trapano kollonë. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p>	

-
- Vëzhgim me listë kontrolli.

